

L I G J
Nr.8043, datë 30.11.1995

**PËR KONTROLLIN E FIGURËS SË ZYRTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË QË
LIDHEN ME MBROJTJEN E SHTETIT DEMOKRATIK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, për të siguruar pastërtinë e jetës demokratike të shtetit shqiptar në periudhën e tranzicionit postkomunist, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Organet dhe funksionet për të cilat ky ligj përcakton kushtet për të shërbyer në to janë:

- a) deputetë në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë;
- b) Presidenti i Republikës, të zgjedhurit nga parlamenti dhe të emëruarit nga Presidenti i Republikës;
- c) anëtarë të qeverisë, sekretarë shteti, zëvendës të tyre, drejtorë të përgjithshëm dhe drejtorë të drejtorive të dikastereve, si dhe të barazuarit me ta në struktura të tjera shtetërore;
- ç) në Presidencë, në administratën e Kuvendit Popullor dhe të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore, të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Kasacionit, të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, të Prokurorisë së Përgjithshme edhe në rangje më të ulëta se ato që përmenden në pikën “c”, nëse nga titullari gjykohet në interes të mbrojtjes së shtetit dhe të të dhënave të tij zyrtare;
- d) guvernatorë, zëvendësguvernatorë dhe drejtorët e Bankës së Shqipërisë;
- dh) në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për oficerët, funksioni organik i të cilëve përfshin gradë të lartë (gjeneral e kolonel), komandantët e njësive të pavarura;
- e) prefektët, kryetarët dhe anëtarët e këshillave të rretheve, kryetarët e bashkive, si dhe komunave dhe anëtarët e këshillave të bashkive e komunave;
- ë) në Shërbimin Informativ Kombëtar (SHIK), në Shërbimin Informativ Ushtarak (SHIU) dhe në Shërbimin Informativ të Rendit (SHIR);
- f) në Gardën e Republikës;
- g) shefa të komisarariatit, shefa të policisë, punonjës të policisë kriminale dhe degëve të tjera speciale;
- gj) gjyqtarë, ndihmësgjyqtarë, prokurorë dhe oficerë në policinë gjyqësore;
- h) në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë;
- i) në RTSH, në ATSH si drejtues dhe redaktorë;
- j) gazetarë dhe punonjës me detyrë më të lartë në gazetatat me tirazh mbi 3000 kopje;
- k) në funksione drejtuese në bashkësitë ekonomike, në institucione shtetërore financiare dhe të sigurimeve, si dhe në bankat shtetërore;
- l) rektorë dhe drejtorë në universitete dhe shkolla të larta.

Neni 2

Për të shërbyer në organet dhe funksionet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, duhet që personi gjatë gjithë periudhës 28.11.1944 gjer më 31.3.1991:

- a) të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, sekretar, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, sekretar i Parë i Komitetit të Partisë së Punës së Shqipërisë në rrethe dhe nivele analoge, punonjës i sektorit për Sigurimin e Shtetit në Komitetin Qendror të PPSH, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare ose është larguar vetë në mënyrë publike;
- b) anëtar qeverie, anëtar i Këshillit Presidential, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i

Përgjithshëm, deputet përpara zgjedhjeve të 31 marsit 1991, me përjashtim të rasteve kur ka vepruar kundër vijës zyrtare ose është larguar vetë në mënyrë publike;

c) të mos ketë punuar si oficer në Sigurimin e Shtetit (legal a ilegal), në repartet e ndjekjes dhe ato të ruajtjes së personaliteteve;

ç) të mos ketë qenë i regjistruar në materialet e Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtor (informator, agjent, rezitent a strehues) ose të mos ketë bashkëpunuar në mënyrë të ndërgjegjshme me Sigurimin e Shtetit (të mos ketë qenë zotërues i një apartamenti të vënë në dispozicion të Sigurimit të Shtetit);

d) të mos ketë qenë denoncues, dëshmitar i rremë ose rëndues në procese politike në dëm të të pandehurve;

dh) të mos ketë punuar si oficer në strukturën e kampeve dhe burgjeve me të dënuar politikë;

e) të mos ketë mbaruar Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të analogëve të saj të mëparshëm në profilin e Sigurimit ose kurse tremujore e lart po në këtë profil, si dhe analogët e tyre jashtë shtetit;

ë) të mos ketë marrë pjesë si hetues, prokuror, gjyqtar a ndihmësgjyqtar në procese politike speciale;

f) të mos ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor i ndonjë shërbimi të huaj zbulimi ose analog i tyre.

Neni 3

Në raste të veçanta, por gjithnjë me miratimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe kryetari i SHIK-ut për punonjësit e vet, për llogari të organit të vet, mund të mos zbatojë kushtin që përcaktohet në shkronjat “c”, “ç”, “dh” dhe “e” të nenit 2, kur zbatimi i tij prek interesa të rëndësishëm të shtetit, kur nuk cenohet qëllimi i këtij ligji.

Neni 4

Për të vërtetuar faktet që përmenden në nenin 2, ngrihet një komision shtetëror i përbërë nga kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë, shtetas të ndershëm dhe me personalitet, dhe që nuk janë deputetë të Kuvendit Popullor.

Kryetari caktohet dhe hiqet nga Kuvendi Popullor. Nënkryetari dhe një anëtar i komisionit caktohen dhe hiqen nga Këshilli i Ministrave, kurse një anëtar do të caktohet dhe hiqet nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Kombëtar.

Anëtarë të komisionit mund të caktohen vetëm ata që nuk kanë kryer veprimtari të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji. Kontrollin e kandidaturave për anëtarë komisioni e kryejnë bashkërisht Kryetari i Këshillit të Ministrave, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Shërbimit Informativ Kombëtar.

Anëtarësia në komision është e pazëvendësueshme. Paga e anëtarëve të komisionit caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Para caktimit si anëtar i komisionit merret mendimi i atij që propozohet.

Neni 5

Veprimtaria e komisionit legjitimohet kur janë të pranishëm kryetari ose nënkryetari, si dhe të paktën katër anëtarë të tij. Punimet e komisionit bëhen të mbyllura dhe vendimet e tij merren me shumicë votash.

Neni 6

Komisioni mund të bëjë verifikime për të provuar faktet që përmenden në nenin 2, si dhe mund të thërrasë për sqarime dhe të interesuarin, specialistë dhe persona që kanë lidhje me çështjen etj.

Në rast refuzimi për të dëshmuar ose dëshmie a ekspertimi të rremë, personat përgjigjen penalisht sipas Kodit Penal.

Neni 7

Komisioni e fillon procedurën kur bëhet kërkesë:

- a) nga personi që do të vërë kandidaturën për zgjedhje në një nga funksionet e nenit 1;
- b) nga qendrat e punës të përmendura në nenin 1;
- c) nga personi që do të punojë në një nga detyrat ose organet që përmenden në nenin 1 (paragrafet b deri në l), e shoqëruar kjo kërkesë me propozimin për emërim;
- ç) nga personi i interesuar, të cilit i bëhen akuza në shtyp a publike, ose nga të afërmit e tij kur ai nuk jeton, kur vendimi u nevojitet për qëllime rehabilitimi, zhdëmtimi apo të vënies në vend të personalitetit, ose kur ka qenë mbajtës i funksioneve që parashikohen në nenin 1 dhe nuk kandidohet më në ato funksione.

Neni 8

Komisioni merr vendim brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës. Në vendim argumentohet nëse personi i plotëson ose jo kërkesat e këtij ligji lidhur me funksionet e përmendura në nenin 1.

Kur në vendim vërtetohet se shtetasi nuk është person nga ata që përmenden në nenin 2, ky fakt duhet të pasqyrohet në të gjitha dokumentet e tij.

Neni 9

Çdo person që do të vërë paskëtaj kandidaturën për zgjedhje në një nga funksionet e nenit 1, duhet të ketë marrë përpara vendimin e komisionit që nuk ka bërë pjesë në asnjë nga funksionet e përfshira në nenin 2.

Kur ai nuk përmbush kushtet për t'u paraqitur si kandidat në zgjedhjet e ardhshme dhe, megjithëkëtë paraqet kandidaturën për regjistrim, njoftohet subjekti i tij elektoral, opinioni publik dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili nuk e regjistron si kandidat.

Kur personi nuk i përmbush kushtet që kërkohen për të punuar në një nga funksionet e përmendura në nenin 1 (paragrafi b deri në l), ai largohet nga puna brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit nga komisioni shtetëror.

Personat që janë kontrolluar sipas këtij ligji dhe që nuk kanë rezultuar të kenë qenë në funksionet që përfshin neni 2, kur përsëritin detyrat e parashikuara në nenin 1, gjatë kohës që është në fuqi ligji, nuk kontrollohen sërish.

Neni 10

Kundër vendimit të komisionit shtetëror personi mund të ankohet në Gjykatën e Kasacionit brenda 7 ditëve nga dita e komunikimit, që duhet të vendosë brenda 15 ditëve.

Neni 11

Ndalohet t'u bëhen të njohura opinionit publik faktet e parashtruara në vendimin e komisionit, si dhe vetë vendimi pa pëlqimin paraprak me shkrim të personit të interesuar me përjashtim të rastit të përmendur në nenin 9 paragrafi i parë.

Neni 12

Kërkesë për verifikim të kryesive të partive dhe shoqatave politike, që janë të pranishme në jetën politike dhe shoqërore të vendit, mund të paraqitet nga ministri i Drejtësisë ose nga vetë kryesitë e tyre, të cilat vihen në dijeni për rezultatet. Në rast të vazhdimit të qëndrimit të këtyre personave në ato struktura, informohet opinioni publik.

Neni 13

Komisioni shtetëror, në funksion të përmbushjes së detyrave të ngarkuara me këtë ligj, ka të drejtë të kërkojë t'i vihen në dispozicion të gjitha materialet arkivore, duke përfshirë dhe dokumentacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë, nga të cilat mund të merren të dhëna për veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit dhe personave të veçantë, që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji.

Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Kombëtar, gjykatat dhe prokuroritë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, janë të detyruara t'i paraqesin menjëherë komisionit, kundrejt kërkesës, të gjitha materialet arkivore të kërkuara.

Komisionit, me kërkesën e tij, duhet t'i vihen menjëherë në dispozicion të gjitha dublikatat e dokumenteve të mësipërme që lidhen me veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit, me platformën e punës së tij ose të shtetasve të veçantë.

Neni 14

Nëse komisioni shtetëror ose organet e ngarkuara me mbrojtjen e rendit kushtetues vërejnë gjatë veprimtarisë së tyre të dhëna për personat e përcaktuar në nenin 1, vënë në dijeni titullarët e strukturave përkatëse, të cilët veprojnë sipas këtij ligji.

Neni 15

Mbajtja dhe përdorimi publik i çdo dokumenti a faksimile të tij jashtë arkivave, të përmendura në nenin 13, si dhe fshehja, zhdukja, falsifikimi dhe çdo mënyrë tjetër e manipulimit të dokumentacionit të Sigurimit të Shtetit dhe të institucioneve të tjera me të dhëna objekt i këtij ligji, si dhe akuzat e rreme publike ndaj individit, përbëjnë vepër penale dhe dënohen me 5 vjet burgim.

Neni 16

Në mungesë të dispozitave të tjera ligjore ndalohet marrja kontakt me dokumentacionin objekt i këtij ligji për vendime që lidhen me personat pas vitit 2001 e deri në vitin 2025. Për ruajtjen e arkivit ngarkohen Shërbimi Informativ Kombëtar, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të hartojë rregullat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi më datë 30 nëntor 1995 dhe shfuqizohet më 31 dhjetor 2001, me përjashtim të neneve 14 dhe 16.

Shpallur me dekreten nr.1311, datë 4.12.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha